



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 212

Tiranë – E enjte, 7 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|--|---|
| Vendim i Kuvendit nr. 113/2017, datë 4.12.2017 | Për ngritjen e nënkomisionit të përhershëm parlamentar “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas” 11153 |
| Rezolutë e Kuvendit, datë 4.12.2017 | Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj..... 11153 |
| Rezolutë e Kuvendit, datë 4.12.2017 | Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara..... 11157 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 23.11.2017 | Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara me ligj..... 11159 |



VENDIM
Nr. 113/2017

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT
TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR
“PËR BARAZINË GJINORE DHE
PARANDALIMIN E DHUNËS NDAJ
GRUAS”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Pranë Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ngrihet nënkomisioni i përhershëm “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas”.

II. Objekti i veprimtarisë së këtij nënkomisioni është:

a) ndërmarrja e hapave të nevojshëm për adresimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave;

b) gjetja e mekanizmave efikasë për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje;

c) propozimi i ndërhyrjeve ligjore të nevojshme që ndihmojnë në përmirësimin e mbrojtjes së grave dhe vajzave dhe rritjes së sigurisë së jetës së tyre;

d) mbikëqyrja parlamentare e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pëmbushja prej tyre e të gjitha detyrimeve ligjore, zbatimi i masave për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe fuqizimi social dhe ekonomik i tyre.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 9 anëtarë. Kryetari i takon shumicës parlamentare dhe zëvendëskryetari pakicës parlamentare. Përbërja e nënkomisionit miratohet me vendim të Kuvendit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.12.2017

REZOLUTË

PËR DËNIMIN E DHUNËS NDAJ GRAVE
E VAJZAVE DHE RITJEN E
EFEKTSHMËRISË SË MEKANIZMAVE
LIGJORË PËR PARANDALIMIN E SAJ

1. Kuvendi i Shqipërisë sjell në vëmendje konventat ndërkombëtare të ratifikuara prej tij, rekomandimet e mekanizmave monitorues dhe legjislacionin e brendshëm, më konkretisht:

1.1. Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj që sanksionojnë se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

1.2. Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën e Kombeve të Bashkuara “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW) dhe protokollin e saj shtesë, si dhe Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19 të Komitetit CEDAW mbi dhunën kundër grave, Konventën e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijëve” dhe protokollet e saj shtesë dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

1.3. Kartën Sociale Europiane të Rishikuar, që kërkon që shtetet anëtare të përmirësojnë standardet e tyre të jetesës dhe mirëqenien e tyre sociale.

1.4. Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, që përcakton detyrimet e shteteve të shmangin përfshirjen në akte dhune kundër grave.

1.5. Konventën e Këshillit të Europës “Mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, që u kërkon shteteve anëtare të marrin të gjitha masat për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, për të mbrojtur viktimat dhe për të hetuar me efektivitet rastet e trafikimit.

1.6. Konventën e Këshillit të Europës “Mbi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi



seksual”, që i kërkojnë shteteve nënshkruese të marrin të gjitha masat ligjore, administrative dhe institucionale ose masa të tjera për parandalimin e të gjitha formave të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve dhe për mbrojtjen e fëmijëve.

1.7. Rekomandimet e Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës mbi mbrojtjen e grave nga dhuna, mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, mbi rolin e burrave dhe grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes, si dhe rekomandime të tjera përkatëse.

1.8. Rekomandimet e Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), të miratuara në vitin 2016 dhe rekomandimet në raportin e parë të vlerësimit mbi Shqipërinë, të Grupit të Ekspertëve të Këshillit të Europës, “Mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)”, të publikuara më 24 nëntor 2017.

1.9. Legjislacionin e brendshëm për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 25), Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Kodi i Procedurës Civile dhe ai i Procedurës Penale, të ndryshuar, Kodi i Punës, i ndryshuar, ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar; ligji nr. 44/2016, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar etj., si dhe një sërë aktesh nënligjore për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit; Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, strategjia kombëtare e barazisë gjinore dhe plani i veprimit 2016-2020 etj.

1.10. Duke vlerësuar barazinë gjinore, ndalimin e diskriminimit dhe dhunën ndaj grave dhe vajzave, si kushte të rëndësishme për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, si dhe një ndër objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, objektivi nr. 5/SDG 5, “Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjithë grave dhe vajzave”, por edhe element thelbësor në përmbushjen e

Objektivit 16: “Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”.

2. KUVENDI I SHQIPËRISË:

2.1. Konstaton me shqetësim ekzistencën në rritje të dhunës ndaj grave dhe vajzave në përgjithësi dhe dhunën brenda familjes në veçanti.

2.2. Vlerëson dhunën ndaj grave si një akt të rëndë për shoqërinë, si dhe dhunën brenda familjes si akte me pasoja të rënda.

2.3. Çmon se dhuna ndaj grave dhe vajzave dhe në veçanti krimet brenda familjes janë akte që tronditin jo vetëm familjen, por të gjithë shoqërinë shqiptare, dhe si të tilla kërkojnë angazhimin e të gjithë shoqërisë për raportimin dhe parandalimin e tyre.

2.4. Mban në konsideratë se parandalimi dhe kufizimi i rasteve të dhunës në familje në të gjitha format e shfaqjes së saj është i ndërlidhur me një sërë faktorësh kulturorë, tradicionalë, socialë dhe ekonomikë, që kërkojnë angazhim të gjithanshëm.

2.5. Vlerëson se me gjithë përpjekjet e të gjitha qeverive dhe organeve të pushtetit vendor për reduktimin dhe parandalimin e dhunës në familje, jemi të vetëdijshëm se mbetet ende shumë për të bërë në mënyrë të koordinuar mes tri pushteteve, ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor, për rritjen e efektshmërisë së mekanizmave institucionale për parandalimin e këtij fenomeni dhe rehabilitimin e viktimave.

2.6. Vëren se sistemi i drejtësisë (policia, prokuroria, gjykatat, shërbimet sociale në sistemin e drejtësisë penale) nuk ka qenë efektiv lidhur me hetimin dhe shqyrtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore të Kodit Penal për dënimin e dhunuesve dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat.

2.7. Afirmon gjithë angazhimin për të nxitur analizimin në mënyrë sistematike të gjendjes së dhunës ndaj grave dhe vajzave, si dhe gjetjen e mekanizmave eficientë institucionale e ligjore për parandalimin e saj.

2.8. Vlerëson rolin aktiv të shoqërisë civile dhe në veçanti të organizatave të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe fëmijëve, viktimat të dhunës në familje.

2.9. Është i ndërgjegjshëm për vështirësinë që paraqet eliminimi i plotë i dhunës ndaj grave dhe



vajzave, përfshirë edhe dhunën në familje.

2.10. Është i ndërgjegjshëm për nevojën e një bashkërendimi efikas nga të gjitha strukturat shtetërore në nivel qendror dhe vendor dhe me shoqërinë civile.

2.11. Vlerëson se rritja e pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje është faktor kyç për fuqizimin e grave dhe vajzave, si dhe në luftën kundër dhunës ndaj tyre.

3. KUVENDI I SHQIPËRISË:

3.1. Dënon fuqimisht aktet e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe në veçanti dhunën në familje, duke i konsideruar jo vetëm si akte kriminale, por dhe fenomene që cenojnë bazën e shoqërisë dhe kërkon masa të ashpra ndaj dhunuesve, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes.

3.2. Angazhohet që brenda 15 ditëve nga miratimi i kësaj rezolute, të krijohet nënkomisioni i përhershëm “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas” pranë Komisionit përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Brenda 60 ditëve nga miratimi i kësaj rezolute, nënkomisioni të hartojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të GREVIOS, CEDAW dhe Konventës së Stambollit si:

a) ndërmarrjen e të gjithë hapave të nevojshëm për adresimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave;

b) gjetjen e mekanizmave efikasë për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje;

c) propozimin e ndërhyrjeve ligjore të nevojshme që ndihmojnë në përmirësimin e trajtimit të grave dhe vajzave dhe rritjes së sigurisë së jetës së tyre;

ç) mbikëqyrjen parlamentare të institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe përbushjen prej tyre të të gjitha detyrimeve ligjore dhe zbatimin e masave për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave.

3.3. Mbështet dhe inkurajon të gjithë viktimat e dhunës në familje që të denoncojnë dhunën, si dhe të bashkëpunojnë me organet kompetente për zbatimin e legjislacionit në fuqi, duke i siguruar për mbikëqyrje të fortë parlamentare dhe trajtim të të gjitha rasteve të denoncimeve për dhunën në familje.

3.4. Nënkomisioni i përhershëm “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas” të informojë seancën plenare, të paktën një herë në çdo sesion parlamentar, mbi rezultatet e punës së institucioneve shtetërore dhe nevojën për marrjen e masave shtesë për parandalimin, reduktimin dhe mbrojtjen e grave ndaj dhunës në familje.

3.5. Angazhohet nëpërmjet komisioneve të tij të përhershme parlamentare dhe nënkomisioneve të tij të monitorojë zbatimin nga autoritetet shqiptare të zbatimit të akteve ligjore, akteve ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe veçanërisht zbatimin e Konventës së Stambollit.

3.6. Kërkon nga Qeveria Shqiptare brenda 60 ditëve nga miratimi i kësaj rezolute:

a) një analizë të plotë mbi të gjitha problematikat e evidentuara në praktikë, si dhe të dhëna konkrete mbi dhunën në familje;

b) të paraqesë propozime konkrete për ndryshime ligjore, me fokus të posaçëm:

i) fuqizimin e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si strukturë përgjegjëse për koordinimin e veprimtarisë së gjithë institucioneve shtetërore të ngarkuara me ligj për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, si dhe garantimin e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, grave, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara;

ii) ashpërsimin e parashikimeve ligjore për heqjen përfundimtare të mundësisë për të përfituar nga amnistia ose nga rrethana të tjera lehtësuese, në të gjitha rastet e hetimit, gjyqimit ose dënimit për krimet brenda familjes;

iii) rishikimin e masave mbrojtëse ndaj dhunës në familje, duke eliminuar situatën e evidentuar në praktikë, ku dhunuesi dhe viktimat e dhunës, edhe pas vendosjes së masës së mbrojtjes, lejohen të bashkëjetojnë në të njëjtin ambient;

iv) forcimin e mekanizmit të mbrojtjes, mbështetjes dhe rehabilitimit të viktimave, me qëllim lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e vijimit të dhunës në familje, duke ofruar plotësimin e të gjitha nevojave për personat e dhunuar në familje, përfshirë asistencë të përshtatshme dhe të mjaftueshme financiare, punësim, strehim, si dhe shërbime mjekësore dhe sociale;

v) rishikimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimës dhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme për rastet e rrezikut për jetën, duke mirëpërcaktuar detyrimet e Policisë së Shtetit në



këto raste, përcaktimin e personave përgjegjës që marrin përsipër të mbajnë nën kontroll dhunuesin, si dhe aplikimin gjerësisht të mbikëqyrjes elektronike për rastin e dhunuesve brenda familjes;

vi) garantimin e mekanizmave rehabilitues për dhunuesin dhe viktimat e dhunës në familje, me fokus të veçantë eliminimin e pasojave të dhunës dhe shmangien e mundësisë së ripërsëritjes së saj në të ardhmen;

vii) ndryshimin e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe VKM-së nr. 334, datë 17.2.2011, për të sanksionuar, ndër të tjera, thjeshtimin e procedurave gjyqësore për shqyrtimin dhe lëshimin e urdhrat të mbrojtjes dhe ndjekjen efektive të ekzekutimit të tij, duke parashikuar në çdo rast vijimin e procesit gjyqësor, pavarësisht tërheqjes së mëvonshme të viktimës, si dhe ngritjen e një mekanizmi eficient të mbikëqyrjes së veprimtarisë së organeve gjyqësore në proceset gjyqësore të dhunës në familje;

viii) angazhimin e të gjitha strukturave të shtetit për të ndryshuar mendësitë dhe ndërgjegjësuar publikun mbi pabarazinë dhe stereotipat e dëmshëm gjinorë, që janë baza e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

c) të merren masa për shtrirjen e regjistrat kombëtar/sistemit REVALB për dhunën në familje dhe plotësimin e këtij sistemi nga strukturat përgjegjëse vendore;

ç) të dhënat e punësimit të grave dhe vajzave, viktimat të dhunës në familje, sipas institucioneve, në sektorin publik dhe privat, dhe në veçanti të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, të jenë pjesë e raporteve periodike të depozituara në Kuvend.

3.7. Kërkon të nxitet ngritja e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit nga njësitë e qeverisjes vendore, të përmirësohet koordinimi i punës me ato ekzistuese, si dhe të rriten fondet e dedikuara nga ana e Qeverisë.

3.8. Kërkon nga njësitë e qeverisjes vendore të marrin të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e mekanizmave vendore aty ku nuk janë ngritur, rritjen e kapaciteteve të tyre, si dhe parashikimin e fondeve të nevojshme për ngritjen dhe financimin e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, duke filluar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2018, dhe të angazhohen maksimalisht për përmirësimin e përgjegjësisë ligjore, në kuadër të

parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

3.9. Duke vlerësuar kontributin e çmuar të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve sociale për viktimat dhe dhunuesit, i fton organizatat jofitimprurëse të licencuara që të vijojnë dhe maksimalizojnë përpjekjet për parandalimin, reduktimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, duke ushtruar të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

3.10. Duke vlerësuar ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, lidhur me mbrojtjen e viktimave dhe trajtimin e tyre në polici, gjatë procedimeve penale, angazhohet të miratohet, brenda këtij sesioni parlamentar, legjislacionin e nevojshëm për mbrojtjen efektive të viktimave të dhunës në familje dhe ndërtimin e një mekanizmi realist për mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

3.11. Ndërkohë që ligji i ri për ndihmën juridike pritet të miratohet së shpejti, nxit Qeverinë të angazhohet për:

a) zbatim të menjëhershëm të dispozitave që kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;

b) të marrë masat e nevojshme për të ofruar mbrojtje efektive për viktimat e dhunës seksuale, si edhe për ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe të mirëkoordinuara për viktimat e mbijetuara.

3.12. Nxit Qeverinë të zbatohet detyrimet ligjore për buxhetimin e përgjithshëm gjinor, sipas ligjit organik të buxhetit dhe VKM-së për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm, si dhe të parashikojë fondet për:

a) një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi mbi pasojat e dhunës ndaj grave dhe vajzave, veçanërisht të dhunës në familje;

b) mbështetjen për riintegrim në shoqëri të viktimave të dhunës;

c) mbështetjen me fonde buxhetore të Linjës Kombëtare të Këshillimit dhe Linjave Lokale për parandalimin e dhunës dhe këshillimin e viktimave;

ç) informimin e publikut për mekanizmat e referimit në nivel vendor dhe rritjen e kapaciteteve të tyre;

d) mbështetje me fonde buxhetore të organizatave të shoqërisë civile që lehtësojnë mekanizmat vendorë aty ku nuk ka ende;



dh) ngritjen e strehëzave për viktimat me fonde buxhetore;

e) forcimin e aksesit në drejtësi përmes financimit të plotë të ligjit të ndihmës juridike, ku të përfshijë viktimat e dhunës si kategori përfituese.

3.13. Nxiti Qeverinë dhe organet e pushtetit vendor për zgjerimin dhe forcimin e politikave për sipërmarrjen e grave duke iu referuar modelit të strategjisë për fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave 2014 – 2020, nëpërmjet skemave të mbështetjes me grante nga shteti, të grave në nevojë, grave në zonat rurale dhe viktimave të dhunës.

3.14. Nxiti Qeverinë t'i kushtojë vëmendje të veçantë detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe veçanërisht atyre në Konventën e Stambollit, si dokumenti bazë sot në Europë për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, dhe që gëzon mbështetje të plotë të Bashkimit Europian. Raporti i vlerësimit të grupit të ekspertëve për Shqipërinë, i publikuar në 24 nëntor 2017, ka parashikuar rekomandime konkrete për masat që Shqipëria duhet të marrë në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

3.15. Organet e pushtetit gjyqësor dhe ato të prokurorisë të trajtojnë me seriozitet, efikasitet dhe me shpejtësi maksimale proceset hetimore dhe gjyqësore që lidhen me çështjet e dhunës në familje, për t'i dhënë zgjidhje reale mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje, si dhe zbatim rigoroz të dispozitave të Kodit Penal për dënimin e dhunuesve.

3.16. Nxiti organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë të mbajnë në konsideratë në mënyrë të veçantë mbajtjen e posaçme të të dhënave për proceset hetimore dhe gjyqësore që kanë të bëjnë me dhunën në familje, duke përfshirë urdhrat e mbrojtjes, proceset gjyqësore për dënimin e dhunuesve etj.

3.17. Nxiti organet e inspektimit të sistemit të drejtësisë që të vlerësojnë me seriozitet shkeljet e prokurorëve dhe gjyqtarëve në gjykimin e çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet kësaj rezolutive, shpreh angazhimin e tij institucional për të trajtuar me vëmendjen e merituar rastet e dhunës në familje, në bashkërendim me organet e pushtetit qendror, vendor dhe ato gjyqësor.

Miraturar në datën 4.12.2017

KRYETARI
Gramoz Ruçi

REZOLUTË

PËR OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË AGJENDËS 2030 TË SHTETEVE ANËTARE TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Në shtator të vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Kjo marrëveshje historike e ndërtuar mbi sukseset e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit krijoi për herë të parë një komizë veprimi universale për të zhdukur varfërinë dhe për të zvogëluar pabarazinë, duke promovuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut.

17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të paraqitura në Agjendën 2030, përshkruajnë në detaje ambicien kolektive të 193 shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara për “çlirimin e njerëzimit nga tirania e varfërisë, shërimin e planetit tonë dhe sigurinë e tij”. Të gjitha shtetet anëtare dhe palët e interesuara janë zotuar që me këtë ambicie të synohet që asnjë individ të mos mbetet pas dore. Motoja e kësaj agjende është “Mos lër askënd pas”.

Ne, anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë, të mbledhur së bashku në këtë seancë plenare:

PËRQAFOJMË Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të miratuara nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara më 25 shtator 2015, në veçanti, Objektivin 16, i cili i kërkon shteteve anëtare të promovojnë qeverisjen paqësore dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar që parlamentet të jenë institucione përfaqësuese, pjesëmarrëse, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.

NJOHIM rolin e rëndësishëm që duhet të luajnë parlamentarët për të promovuar, zbatuar dhe monitoruar Agjendën 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, përmes hartimit dhe miratimit të ligjeve, buxhetit, si dhe funksioneve të



mbikëqyrjes dhe përfaqësimit.

PRANOJMË rëndësinë e tri dimensioneve të zhvillimit të qëndrueshëm, ekonomik, social dhe mjedisor, si edhe nevojën për t'i trajtuar ato në mënyrë gjithëpërfshirëse, në lidhje të ngushtë me masat për të përmirësuar strukturën institucionale dhe kapacitetet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

NËNVIZOJMË se paqja dhe siguria, demokracia dhe sundimi i ligjit, eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit, fuqizimi i grave, angazhimi i brezave të rinj dhe, së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, qeverisja e mirë, janë kërkesa thelbësore për të siguruar një evolucion të pakthyeshëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

ANGAZHOHEMI për të bashkëpunuar ngushtë me strukturat qeveritare, institucionet e pavarura dhe shoqërinë civile, universitetet dhe sipërmarrjen, për të mbështetur zbatimin gjithëpërfshirës, transparent dhe të përgjegjshëm të Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

ANGAZHOHEMI për të përmbushur moton e Agjendës 2030: “Mos lër askënd pas”, veçanërisht grupet në nevojë.

PËRSHËNDESIM bashkëpunimin midis partnerëve tanë ndërkombëtarë për zhvillim me parlamentarët dhe aktorët e tjerë kombëtarë, për të realizuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për të përmbushur Agjendën e vitit 2030.

INKURAJOJMË krijimin e sinergjive midis përmbushjes së objektivave të Agjendës 2030 në vendin tonë dhe integritet të plotë të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Të mbledhur sot në seancë plenare, angazhohemi se:

1. Do të reflektojmë mbi mekanizmat ekzistues të mbikëqyrjes parlamentare, për të siguruar që parlamentarët të kenë mjetet e duhura për të udhëhequr dhe monitoruar arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke përfshirë:

i) shqyrtimin e rregullores ekzistuese, për të siguruar që komisionet parlamentare të përfshijnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në agjendën e tyre të punës;

ii) orientimin e Qeverisë (Komitetin Ndërmintor për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për të përmbushur Agjendën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si në nivel kombëtar, ashtu edhe vendor, duke përfshirë

organizimin e seancave dëgjimore me komisionet e përhershme parlamentare dhe/ose nënkomisionet e tij;

iii) forcimin e kapaciteteve të komisioneve parlamentare për të siguruar një mbikëqyrje efektive të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke siguruar që anëtarët e komisioneve të kenë staf dhe burime të mjaftueshme e të kualifikuara për të ndërmarë dhe zbatuar procese të mbikëqyrjes me pjesëmarrje dhe transparencë;

iv) sigurimin e zhvillimit dhe përdorimit të mjeteve për t'u mundësuar parlamentarëve të kryejnë një mbikëqyrje më efektive të ligjeve, të buxheteve, programeve dhe politikave të propozuara për të vlerësuar kontributin e tyre në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

2. Do të punojmë së bashku me Qeverinë dhe të gjithë partnerët dhe grupet e interesit, për të rishikuar kuadrin ligjor ekzistues dhe identifikuar mundësitë për të çuar më tej zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht miratimin ose ndryshimin e ligjeve për të promovuar barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e mjedisit.

3. Do të rishqyrtojmë mekanizmat ekzistues buxhetorë parlamentarë për të siguruar që:

i) ndarjet buxhetore dhe shpenzimet të analizohen, me qëllim që të kontribuojnë sa më efektivisht në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm;

ii) analiza e buxhetit të përfshijë burime të brendshme dhe të jashtme që u mundësojnë parlamentarëve të promovojnë efektivitetin dhe eficiencën e zhvillimit.

4. Do të ofrojmë mbështetje për institucionet qeverisëse në nivel vendor për të zbatuar dhe monitoruar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke pranuar se ato janë më afër me qytetarët dhe shpesh kanë përgjegjësi për çështje të rëndësishme në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

5. Do të bashkëpunojmë ngushtë me Institutin e Statistikave (INSTAT), për të inkurajuar nxjerrjen e të dhënave të ndara nga perspektiva gjinore, si dhe për t'u mundësuar parlamentarëve qasje dhe kuptim më të mirë të të dhënave, në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke përfshirë edhe



vlerësimin më të mirë të ndikimit gjeografik dhe demografik të aktiviteteve të ndërlidhura me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

6. Do të nxisim bashkëpunimin me institucione të pavarura të llogaridhënies siç janë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, organet e angazhuara në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Bashkëpunimi do të intensifikohet edhe me median, partnerët ndërkombëtarë, shoqërinë civile, sipërmarrjen për t'u mundësuar parlamentarëve të zhvillojnë partneritete që do të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të nxitur, zbatuar dhe monitoruar arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

7. Do të mbështesim zhvillimin e proceseve dhe mekanizmave për të forcuar përfshirjen parlamentare, qasjen në informacion, llogaridhënien dhe transparencën për të inkurajuar përfshirjen më të madhe të shoqërisë civile, të universiteteve, si edhe angazhimin e publikut, veçanërisht nga grupet në nevojë dhe të mënjanuara, në hartimin ose përmirësimin e legjislacionit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij dhe politikave kombëtare që synojnë përmirësimin e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

8. Do të organizojmë në mënyrë periodike aktivitete ndërgjegjësimit dhe informimi për parlamentarët dhe stafin e Kuvendit në mënyrë që të sigurohet informacioni i përditësuar mbi aktivitetet dhe proceset ndërkombëtare, rajonale dhe vendore që lidhen me zbatimin e Agjendës 2030 dhe Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Miraturuar në datën 4.12.2017

KRYETARI
Gramoz Ruçi

VENDIM

Nr. 75, datë 23.11.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---------------|--------------------------------|
| Bashkim Dedja | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vitore Tusha | Anëtare e “ “ |
| Fatmir Hoxha | Anëtar i “ “ |
| Gani Dizdari | Anëtar i “ “ |
| Besnik Imeraj | Anëtar i “ “ |
| Fatos Lulo | Anëtar i “ “ |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.10.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 51 akti që i përket:

KËRKUES: Saime Maho, Arben Maho

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bashkia Tiranë

Zyra Përmbartimore Tiranë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara me ligj.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, Saime Maho dhe Arben Maho, që kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Zyrës Përmbartimore Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit kanë qenë qiramarrës të një banese shtetërore, apartament 2+1 në rrugën “Mine Peza”. Në datën 3.6.1989 nga ana e kryefamiljarit A. M., me pëlqimin edhe të kërkuësve, është lidhur aktmarrëveshja me Komitetin Ekzekutiv Popullor të rajonit nr. 3 Tiranë, ku trashëgimlënësi A. M. do të përfitonte një apartament në një pallat tjetër në



rrugën “Urani Pano”. Kjo aktmarrëveshje është zbatuar nga kërkuesit, por duke qenë se nga ana e organeve të qeverisjes vendore kjo aktmarrëveshje nuk po zbatohet, kërkuesit kanë paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 744, datë 8.2.2007, ka vendosur: *“Pranimin e padisë së paditësve Saimë Mabo dhe Arben Mabo. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të zbatojë detyrimin që rrjedh nga aktmarrëveshja e datës 3.6.1989, lidhur midis trashëgimlënësit të paditësve, A. M. me organet e pushtetit lokal.”*

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 388, datë 20.2.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 744, datë 8.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 21.4.2008, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr. 744, datë 8.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Pas ankimit të bërë nga Bashkia Tiranë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 179, datë 30.5.2008, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 744, datë 8.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2010-249, datë 12.3.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Bashkia Tiranë.

II

7. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

7.1. Bashkia Tiranë ka zvarritur në mënyrë të tejzgjatur dhe të pajustificuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke mos marrë asnjë hap konkret për ekzekutimin e tij, në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës.

8. **Subjekti i interesuar, Zyra Përmbartimore Tiranë**, në informacionin e sjellë pranë Gjykatës, pretendon se ka bërë të gjithë procedurën për të bërë të mundur ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

9. **Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

10. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individu, në kuptim të neneve 131/1/f, 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kërkuesit kanë interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe në rastin konkret ata u janë drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së tyre. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, kërkuesit i janë drejtuar shërbimit përmbartimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm dhe kjo e fundit më tej ka vijuar procedurat për vënien në ekzekutim të këtij vendimi.

12. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesja legjitimohet për t’iu drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ajo ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. Për pretendimin e moszekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

13. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për



realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

15. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimin nr. 14, datë 30.03.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe të autoriteteve përkatëse.

18. Duke e vlerësuar çështjen konkrete në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme, në rastin konkret rezultoi se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë është pezulluar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vitin 2008 dhe po Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vitin 2010 ka vendosur mospranimin e rekursit

të paraqitur nga Bashkia Tiranë. Nga data kur Kolegji Civil ka vendosur mospranimin e rekursit, deri në paraqitjen e kërkesës përpara kësaj Gjykate ka kaluar një periudhë më shumë se 7-vjeçare. Një periudhë e tillë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor konsiderohet si një afat i paarsyeshëm dhe i gjatë.

i. Kompleksiteti i çështjes

19. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, çështja në shqyrtim ka për objekt moszekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm për dorëzimin e apartamentit kërkuesve sipas aktmarrëveshjes së lidhur midis palëve. Kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

ii. Interesi dhe sjellja e kërkuesit

21. Në rastin konkret, interesi i kërkuesve është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitorë lidhet me të drejtën e tyre për të zbatuar aktmarrëveshjen e datës 3.6.1989. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezultoi se kërkuesit kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ata kanë shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezultoi të jenë bërë shkak apo të kenë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

22. Të ndodhur përpara faktit se aktmarrëveshja e datës 3.6.1989 nuk po zbatohet nga institucionet përkatëse, kërkuesit kanë paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 744, datë 8.2.2007, ka vendosur: *“Pranimin e padisë së paditësve. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të zbatojë detyrimin që rrjedh nga aktmarrëveshja e datës 3.6.1989, lidhur midis trashëgimlënësit të paditësve, A. M. me organet e pushtetit lokal.”* Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 388, datë 20.2.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 744, datë 8.2.2007, të Gjykatës së



Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 21.4.2008, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr. 744, datë 8.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas ankimit të bërë nga Bashkia Tiranë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 179, datë 30.5.2008, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 744, datë 8.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2010-249, datë 12.3.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Bashkia Tiranë. Më pas, kërkuesit i janë drejtuar Bashkisë Tiranë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, me shkresën nr. prot. S-5143, datë 4.4.2012. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. prot. S-5143/1, datë 17.4.2012, u ka kthyer përgjigje kërkuesve, duke u shprehur se është duke ndjekur rrugën institucionale për të mbështetur në kuadër ligjor zgjidhjen e problematikës së strehimit të tyre. Pas këtyre veprimeve janë përsëri kërkuesit të cilët, me shkresën nr. prot. S-7990, datë 5.6.2014, i kanë kërkuar përsëri Bashkisë Tiranë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. prot. S-7990/1, datë 18.6.2014, u ka kthyer përgjigje kërkuesve, duke u shprehur se ka ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Më pas janë përsëri kërkuesit të cilët, me shkresën nr. prot. S-8784, datë 25.6.2014, vënë në dijeni Bashkinë Tiranë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2010-249, datë 12.3.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Bashkia Tiranë.

iii. Sjellja e autoriteteve

23. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih*

vendimin nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

24. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 79, datë 27.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Në lidhje me autoritetet publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet sjellja e secilit prej tyre. Për sa u përket veprimeve të përmbauesit gjyqësor shtetëror, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit, rezulton se zyra e përmbaimit i është drejtuar Bashkisë Tiranë për ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor të formës së prerë me shkresën nr. 5622 prot., datë 8.5.2008. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 4515/2 prot., datë 26.6.2008, i ka kthyer përgjigje zyrës përmbaimore, duke u shprehur se ka ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Me shkresat nr. 11656 prot., datë 28.10.2011, nr. 4099 prot., datë 27.1.2012, nr. 10349 prot., 21.10.2014 dhe nr. 9243 prot., datë 26.9.2016, zyra përmbaimore ka urdhëruar Bashkinë Tiranë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Me shkresën nr. 29357/1 prot., datë 21.10.2016, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Bashkisë Tiranë i ka dërguar për zbatim shkresën e fundit të dërguar nga zyra përmbaimore Drejtorisë së Strehimit Social në Bashkinë Tiranë. Kjo e fundit, me shkresën nr. 29357/2 prot., datë 11.11.2016, i ka kthyer përgjigje Drejtorisë Juridike të Bashkisë Tiranë se struktura përgjegjëse për trajtimin e kësaj çështje është Enti Kombëtar i Banesave. Me shkresat nr. 904 prot., datë 11.1.2017, dhe nr. 909/1 prot., datë 7.2.2017, Drejtoria Juridike e Bashkisë Tiranë i është drejtuar zyrës përmbaimore, ku i kërkon vënien në dispozicion të kopjeve të njësuara me origjinalin me vulë gjykate ose të noterizuara të vendimeve gjyqësore. Me shkresën nr. 1182 prot., datë 13.2.2017, zyra përmbaimore i ka dërguar Drejtorisë Juridike të Bashkisë Tiranë vendimet gjyqësore sipas kërkesës së kësaj të fundit. Drejtoria Juridike e Bashkisë Tiranë, me shkresën nr.



21815/1 prot., datë 13.7.2017, i ka dërguar zyrës përmbartimore një memo të përgatitur nga Drejtoria e Strehimit Social. Nga përmbajtja e memos rezulton se Drejtoria e Strehimit Social i është drejtuar kryetarit të Bashkisë Tiranë, duke i sjell në vëmendje se duhet të bëhet ekzekutimi i detyrimit, ku përfshihet: “Detyrimi i palës së paditur Bashkia Tiranë të zbatojë aktmarrëveshjen e datës 3.6.1989, lidhur midis trashëgimlënësit të paditësve, Ali Maho me organet e pushtetit lokal.”

26. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se veprimet e përmbartësve gjyqësor shtetëror, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit, kanë qenë formale. Edhe pse ai i ka dërguar disa shkresa debitorit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nuk rezulton që të ketë marrë ndonjë masë tjetër ligjore, siç është vendosja e sanksioneve apo dhe kallëzimi penal për pengim të ekzekutimit.

27. Më tej, Gjykata ka theksuar se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet i paekzekutuar dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Referuar veprimeve konkrete dhe sjelljes së debitorit, Gjykata vlerëson se ky i fundit nuk ka marrë masat e duhura për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të gjente mjetin e përshtatshëm ligjor për zbatimin e aktmarrëveshjes së datës 3.6.1989, si një detyrim ligjor i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë është titull ekzekutiv.

29. Në përfundim, Gjykata vlerëson se organet shtetërore, nëpërmjet sjelljes së tyre, kanë cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mos-ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mos-ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

| | |
|--|-----------------|
| | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë